

REPUBLIKA E KOSOVËS
BASHKËSIA ISLAME E KOSOVËS
Kryesia

REPUBLIC OF KOSOVA
ISLAMIC COMMUNITY OF KOSOVA
The Presidency

Nr. 645/24 Data: 27.05.2024



جمهورية كوسوفا
الاتحاد الإسلامي في كوسوفا
رئاسة الاتحاد

رقم:
التاريخ:

Për: Këshillat e Bashkësisë Islame në territorin e kësaj Kryesie

Lënda: QARKORE

për tubimin e të mirave materiale për blerjen e objektit vakëf në Preshevë

Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, përmes kësaj Qarkoreje (thirrur në mbledhjen e rregullt të Kryesisë së BIK-ut dt. 23.05.2024, bazuar në kërkesën e Këshillit të BI-së në Preshevë me nr. protokoli 645/24, dt. 22.05.2024), bën thirrje që ditën e xhuma (datë 31 maj 2024), në të gjitha xhamitë e Kosovës të organizohet aksion për tubimin e mjeteve financiare për blerjen e një objekti me sipërfaqe 350 m² që do të shfrytëzohet vakëf nga Këshilli i Bashkësisë Islame në Preshevë. Blerja dhe mobilimi i objektit të destinuar për vakëf, arrin vlerën e 420 mijë eurove.

Kjo hapësirë e objektit parashihet që të shfrytëzohet për aktivitete fetare islame, humanitare dhe sociale, për zhvillim të sektorit të rinisë dhe atë të gruas, si dhe për marrdhënie me publikun dhe mediat.

Përmes këtij aksioni shpresojmë të kontribuojmë edhe më, në ruajtjen e identitetit tonë kombëtar dhe fetar, në ruajtjen e vlerave kulturore dhe historike të qytetarëve shqiptarë që jetojnë dhe veprojnë në Kosovën Lindore, gjegjësisht në Luginën e Preshevës.

Besojmë fuqishëm që edhe kësaj radhe nuk do të mungojë përkrahja e xhematit tonë për këtë nismë, ashtu siç vazhdimisht kanë përkrahur çdo nismë tjetër të këtij lloji, sidomos kur aksione të tilla kishin të bëjnë me pjesën më të ndjeshme të trojeve tona – Kosovën Lindore.

Poashtu kërkojmë nga imamët tanë të nderuar, që hytben e kësaj xhumaje t'ia kushtojnë vlerës dhe rëndësisë së institucionit të vakëfit, blerjes, ruajtjes, përkujdesjes dhe mirëmbajtjes së tij në Islam.

Emri i bankës: **NLB banka**

Swift Code: NLPR XK PR

Xhiorollogaria: **XK051700200100103672**

Përfituesi: **KRYESIA E BASHKESISE ISLAME TE KOSOVES**

Përshkrimi: **donacion për blerjen e vakëfit në Preshevë**

Prishtinë

27 maj 2024



KRYETARI,

Myftiu Naim ef. TËRNAVA